

PROCESVERBAL
nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 24.04.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:05 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 4-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.04.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.04.2025.
3. Shqyrtimi i Raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga data 1 janari deri më 31 mars 2025.
4. Propozim për ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 me Propozim-Vendim.

5. Propozim-vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, me Propozim- dokumentacion konkursi dhe Propozim-aplikim.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip, për shkelje të nenit 55 paragrafi (2) të LSHMAAV dhe nenet 25 dhe 26 të Udhëzimit për plasim të produkteve.
7. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport - import Saraj, Shkup.
8. Propozim për shpallje të konkursit publik për fillimin e marrëdhënies së punës për 2 (dy) përmbartues dhe zbatimin e procedurës për punësim me kohë të pacaktuar me propozim-vendim dhe propozim-konkurs publik.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 4-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 16.04.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 16.04.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportet Tremujore të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga data 1 janar deri më 31 mars 2025.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunoviq, shpjegoi Propozimin për ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025, së bashku me Projekt-vendimin. Ai sqaroi se shpenzimet në total të planifikuara mbeten të pandryshuara në lidhje me totalin e përcaktuar më parë dhe arrijnë në 202.429.722,00 denarë. Me ribalancin parashihet rishpërndarja e mjeteve në kuadër të pozitës së njëjtë, pa rritur buxhetin total. Qëllimi i ribalancit është të sigurohen mjete për pagesën e kompensimit mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për muajt maj dhe qershor 2025, në shumën prej 2.100.000,00 denarë, dhe pagesë të shpërblimi jubilar për dy punonjës të Agjencisë, në shumë totale prej 100.000,00 denarë. Mjetet sigurohen përmes rialokimit të brendshëm të buxhetit, pa barrë shtesë financiare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e ribalancit të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, nr.05-1135/1 datë 20.03.2025.

Shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025 mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht arrijnë në 202.429.722,00 denarë.

Me ribalancin e propozuar sigurohen mjetet financiare të destinuara për:

- Pagesë të kompensimit mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për muajin maj dhe qershor 2025 në shumë totale prej 2.100.000,00 denarë dhe
- Pagesë të shpërblimi jubilar për dy punonjës të Agjencisë, në shumë totale prej 100.000,00 denarë.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi Propozim-vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, me Propozim-dokumentacion konkuesi dhe Propozim-aplikim. Ajo shpjegoi se, në pajtim me Ligjin, nëse drejtuar Agjencisë do të dorëzohet kërkesë për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes, së pari është e nevojshme të përgatitet një Studim për të përcaktuar nëse ka arsyetim për një hap të tillë. Studimi i kryer përcaktoi se ekziston arsyetim për shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, për shërbim programor – radio muzikore me format të specializuar, me transmetim dominues muzikë argëtuese. Me vënien e një shërbimi të tillë në radio do ta pasurohet oferta mediatike për qytetarët e Prilepit, veçanërisht duke pasur parasysh se radiostacionet ekzistuese që transmetojnë programe në këtë zonë, në kuadër të 266 orëve muzikë në javë, deri në 184 orë i kushtohen muzikës popullore, nga të cilat 127 orë janë muzikë popullore e kompozuar rishtazi. Kërkesa që është paraqitur ka të bëjë me një stacion në radio që do të transmetojë muzikë argëtuese, e cila përfaqëson një shtesë përmbajtjeje. Përveç kësaj, ajo shpjegoi se është marrë në konsideratë edhe potenciali i përgjithshëm i komunës së Prilepit, e cila karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm banorësh dhe subjektesh ekonomike, gjë që tregon për kushte të favorshme dhe nga aspekti i publikut dhe nga aspekti i tregut të reklamave. Meqenëse Studimi konfirmoi ekzistencën e arsytimit, ajo informoi se kolegët nga sektori juridik e përgatitën Kërkesën, dokumentacionin e konkursit dhe Propozim-vendimin, të cilat janë dorëzuar si shtojcë e materialeve për këtë pikë.

Z. Petrushevski sqaroi se në këtë konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në komunën e Prilepit mund të aplikojë çdo palë e interesuar që i plotëson kushtet e përcaktuara, përfshirë edhe parashtruesin e aplikimit fillestar. Ai shprehu mbështetje për vendimin e propozuar dhe shpreson se do të aplikojnë më shumë palë të interesuara, gjë që do të mundësojë përzgjedhjen e ofertës me cilësi më të lartë.

Z. Fidanoski shprehu mbështetje për këtë pikë. Ai theksoi se aplikanti e njeh mjaftueshëm dhe se kemi të bëjmë me subjekt i cili tashmë funksionin suksesshëm në

fushën e transmetimeve. Radiostacionet e tij kanë një frekuencë muzikore të dallueshme dhe një koncept programor të zhvilluar me sukses. Në lidhje me formatin e propozuar të radiostacionit të ri, i cili do të transmetohet në zonën e një rajoni tjetër, ai theksoi se edhe nëse paraqitet dhe një subjekt tjetër i interesuar, pavarësisht se kush do të zgjidhet, sepse, në pajtim me Ligjin, të gjithë kanë akses dhe mundësi të barabarta, ai beson se bëhet fjalë për iniciativë që do të shndërrohet në një histori të suksesshme mediatike për rajonin e Prilepit. Prandaj, ai përsëriti se do ta mbështeste propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpallje të konkursi publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit me dokumentacion konkursi dhe Aplikacion, për shërbim programi radio muzikore me format të specializuar, deri në 5% përmbajtje folëse, në gjuhët maqedonase dhe serbe, në të cilën muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese, dhe do të transmetohet nëpërmjet një frekuence të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike (AKEEK), përkatësisht: 90.3 MHz.

Leja do të jepet për një periudhë prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të PMV-së", në ueb faqen e Agjencisë, dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët në RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Pika 6

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR "24 VESTI" SHPKNJP Shtip, për shkak të shkeljes së nenit 55 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), si dhe nenet 25 dhe 26 të Udhëzimit për plasimin e produkteve. Ajo informoi se bëhet fjalë për raport nga mbikëqyrja e rregullt programore për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në LSHMAAV, gjatë të cilit është konstatuar se televizioni, në kuadër të njërit prej emisioneve të tyre, nuk i përmbahej rregullave për plasim të produkteve në programet audiovizuele, as rregullave për shënimin e duhur të programeve që përmbajnë këtë formë plasimi. Duke marrë parasysh se kjo është shkelja e parë e këtij neni të Ligjit gjatë këtij viti, propozohet të shqiptohet masë vërejtje publike, me një afat prej 20 ditësh për harmonizim me rregullativën. Pas skadimit të këtij afati të kryhet mbikëqyrje kontrolli për kontroll të harmonizimit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore, nr.10-1372/1 datë 27.03.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafi (2) nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LSHMAAV dhe nenet 25 dhe 26 të Udhëzimit për plasim të produkteve, sepse më 4 mars 2025, në emisionin e specializuar informativ "Faktor zdravej me Biljana Debarlievën ", nuk u respektuan kushtet për plasim të produkteve në programet audiovizuele, si dhe rregullat për shënimin e programeve që përmbajnë plasim produktesh.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, transmetuesi në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me

dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Udhëzimin për plasim të produkteve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përpiloi Aktvendim për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas shqiptimit të masës (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar)

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport-import Saraj, Shkup.

Spektori për përkrahjen punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 8

Z. Trajčevski shpjegoi Propozimin për shpalljen e konkursit publik për fillimin e marrëdhënies së punës së dy (2) persona, si dhe zbatimin e procedurës për punësim me kohë të pacaktuar, të shoqëruar me Propozim-vendim dhe Propozim- tekst të konkursi publik. Ai shpjegoi se ish-drejtuksi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm nuk është më i punësuar në Agjenci, pasi që është emëruar nga Qeveria si drejtor i Organit Revizor për revizion të IPA fondeve. Në pajtim me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, Agjencia është e detyruar të punësojë revizor të brendshëm. Përveç kësaj, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhës maqedonase, Agjencia është e detyruar të sigurojë lektor të punësuar të gjuhës maqedonase, i cili do të sistematizohet në Njësinë për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe marrëdhënie me publikun. Për të mos shkelur këto dy dispozita ligjore, propozohet të shpallet njoftim publik për të plotësuar të dy pozicionet e punës. Ai gjithashtu informoi se, pas miratimit të Vendimit nga Këshilli, njoftimi publik duhet të publikohet në dy gazeta ditore - në gjuhën maqedone dhe shqip. Agjencia ka nënshkruar tashmë një marrëveshje me gazetën "Koha" për shpalljen e njoftimeve në gjuhën shqipe. Megjithatë, marrëveshja me gazetën "Sloboden Peçat", i cili u zgjodh si ofertues më i favorshëm për gjuhën maqedonase, ende nuk është lidhur për shkak të një ankese të paraqitur nga gazeta "Veçer". Procedura është në fazë miratimi nga Komisioni i Ankesave për furnizim publik. Përzgjedhja e një gazete për shpallje të njoftimit në gjuhën maqedonase do të vazhdojë menjëherë pas marrjes së vendimit nga Komisioni, varësisht nëse vendimi i Agjencisë do të pranohet ose do të urdhërohet përsëritja e procedurës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për shpallje të konkursi publik për krijimin e një marrëdhënie pune dhe zbatimin e procedurës për punësim në Shërbimin Profesional të Agjencisë për vendet e punës në vijim:

- Udhëheqës Sektori për revizion të brendshëm, 1 (një) përmbarues, me kohë të pacaktuar, dhe
- Bashkëpunëtor i Lartë - Lektor i Gjuhës Maqedonase në Njësinë për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe marrëdhënie me publikun pranë Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, 1 (një) përmbarues, me kohë të pacaktuar.

Përzgjedhja e kandidatëve që do të themelojnë marrëdhënie pune me Agjencinë do të kryhet nga Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Njoftimi publik do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, duke filluar nga dita shpalljes në gazetatat ditore.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Njoftimin publik ta publikojë në 2 (dy) gazeta ditore, përkatësisht: 1 (një) gazetë ditore që botohet në gjuhën maqedonase dhe 1 (një) gazetë ditore që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, me shpenzime të Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele si punëdhënës.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshilli,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**